



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (2) (italisht)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë seminare

Viti / Semestri : Viti I , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda **Gjuhë e huaj C (niveli i avancuar 2)** i drejtohet studentëve të vitit të parë Master i Shkencave (FGJH, UT) Lënda i shërben mësimin të gjuhës së huaj në nivel të avancuar gjuhësor. Për këtë studenti duhet të ketë përfutur njohuri të gjuhës italiane në nivel B2 dhe C1. Ky kurs mundëson gjithashtu përvetësimin dhe thellimin e dijeve në lidhje me strukturat dhe leksikun e disa tipologjive të gjuhëve specialistike.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

- 1.Të shprehet rrjedhshëm në gjuhën italiane.
- 2.Të jetë në gjendje të bisedojë dhe të shkëmbejë mendime në lidhje me tema të caktuara të nivelit akademik
- 3.Të lexojë dhe përkthejë tekste të ndryshme qoftë letrare apo artikuj gazetash, si edhe materiale të tjera me përmbajtje specialistike

Rezultatet e pritshme:

- 1.Zhvillimi i rrjedhshmërisë dhe saktësisë gjuhësore në gjuhën italiane, në nivelin C1, si në të folur ashtu edhe në të shkruar, në kontekste akademike dhe specialistike.
- 2.Aftësimi në përkthimin, përmbledhjen dhe interpretimin e materialeve të ndryshme, përfshirë tekste letrare, artikuj të shtypit dhe tekste me përmbajtje profesionale ose teknike.
- 3.Përdorimi efektiv i shprehjeve frazeologjike dhe fjalorit të avancuar, duke shprehur ide të strukturuar dhe mendime të argumentuara në situata të ndryshme komunikimi.